



Npi – 01/431 datë: 24.12.2024

Duke u bazuar në nenin 43 dhe 49 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040, si dhe në bazë të nenit 4.13 të Rregullores së Punës të Kuvendit dhe Komiteteve, Npi – 01/155 të datës 27.04.2023, për mbledhjen e Kuvendit të Komunës, të mbajtur më 24.12.2024, është nxjerrë:

E K S T R A K T
P R O C E S V E R B A L

I Mbledhjes së -XII-të, të rregullt, të Kuvendit të Komunës së Shtimes,
mbajtur më datë 24.12.2024 (e martë), në ora 09:00h, në sallën e Kuvendit.

Në mbledhjen e Kuvendit, kanë marrë pjesë: Kryesuesi i Kuvendit, z.Adnan Ademi, anëtarët e Kuvendit: z.Besnik Seferi, z.Gëzim Haxhiu, z.Asllan Beqaj, znj.Shkurte Mustafa, znj.Saniye Sadiki, znj.ZejnijeVeliu, z.Kadri Emini, znj.Rrezartë Ramadani, z.Muhamet Ademaj, z.Artan Lubovci, z.Përparim Ramusa, z.Rrahman Jakupi, z.Lumni Amrush, znj.Besartë Musliu-Spahija, z.Hasan Avdyli, znj.Albana Podvorica, znj.Adelina Beqaj, z.Rexhep Gashi dhe z.Reshat Mujota.

Përveç anëtarëve të Kuvendit në mbledhje kanë marrë pjesë edhe: Kryetari, z.Qemajl Aliu; Të gjithë drejtorët e drejtorive komunale; Shefja e Kabinetit të Kryetarit, znj.Anita Kurti; Asistente e Kryesuesit të Kuvendit znj.Gentiana Mehmeti; Nga Zyra për Informim; znj.Vlora Hyseni dhe z.Albion Shabani; Zyrtarë i TI-së, z.Shpëtim Gashi.

Mbledhjen e hapi Kryesuesi i Kuvendit, z.Adnan Ademi, i cili, pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, Konstatoi Kuorumin e mjaftueshëm për mbajtjen e mbledhjes. Për këtë seancë kemi propozuar këtë:

REND DITE

1. Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më: 29.11.2024,
2. Propozim-Vendim për anulimin e Vendimit Npi-01-156 dhe Planin për Integritet Npi-01-157 të datës 27.04.2023,
3. Propozim-Vendim për plotësim-ndryshimin e vendimit Npi- 01-291 dt. 27.09.2022 për KKSB,
4. Raporti i përgjithshëm i 6-mujorit të II të i Punës së ekzekutivit në Komunën e Shtimes,
5. Shqyrtimi i Draft-Planit të Punës së Kuvendit dhe Orarit të mbledhjeve për vitin 2025,
6. Pyetje – Përgjigje.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Hapi diskutimin për rendin e ditës.

z.Reshat Mujota: Përshëndetje. Sa i përket rendit të ditës te pika e 4 “Raporti i përgjithshëm i 6-mujorit të II të i Punës së ekzekutivit në Komunën e Shtimes” une po kërkoj që kjo pike të shtyhet sepse na ka ardhur me vonesë, dhe nuk kemi pas mundesi me e perpunuar. Pastaj e kemi pas me plan të punës, një informatë për punën e KRM “Pastërtia” dhe nuk është futë në rendin e ditës.

znj.Adelina Beqaj: Përshëndetje. Unë propozoj që ta shtojmë një pikë lidhur me ndërtimin e objektit të Komunës, dhe zhvendosja e KRM “Pastërtia” sepse ka shqetësime nga qytetarët. Nuk

ka askund që Komuna me qenë në periferi. Pastaj duhet ta dime se si qendron puna me Planin Zhvillimor sa i përket objektit të Komunës. Pastaj nuk ka pas diskutim publik me qytetarë.

z.Muhamet Ademaj: Përshëndetje. Në emër të AKR-së ne e përkrahim rendin e ditës, të propozuar nga Kryetari dhe Kryesuesi.

z.Besnik Seferi: Përshëndetje. Çështjen e informatës që e potencoim Reshati për KRM “Pastërtia” për ta futur si pikë shtesë unë nuk pajtoj. Ne si anëtarë të komisionit sigurisht që do ta japim një informatë të përgjithshme të përgatitur mirë për KRM “Pastërtia”, kur të futet si pikë e rregullt e rendit të ditës.

z.Përparim Ramusa: Përshëndetje. Më nxiti Besniku për me diskutuar, me far logjike ky thot që mos me shty pikën 4 kur materiali na ka arritur me vonesë. Duhet të jemi pak më të sigurtë, sepse materialin na i kan pru dje. Pajtohemi me propozimin e Adelinës, për pikën shtesë.

z.Rexhep Gashi: Përshëndetje. Materiali na ka ardhur me vonesë, nuk ka një kërkim falje. Disa nuk po e dinë rolin e tyre a janë pozitivë apo negativë. Në rendin e ditës nuk është futur Informata e KRM “Pastërtia” e që është dashur në bazë të planit të punës të Kuvendit. Materiali i ka 60 faqe të formatit A4 dhe nuk mundemi me e përpunuar për këtë kohë kaq të shkurtë.

* **Kuvendi i Komunës së Shtimes me 11 vota “Për” me 8 vota “Kundër” dhe me 0 vota “Abstenim”, miratoi rendin e ditës.**

Pika 1

Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më: 29.11.2024

Kryesuesi, z.Adnan Ademi hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Gëzim Haxhiu: Përshëndetje. Kamë një vërejtje për Idajetin, sepse nuk ma kishte përfshi në masë të madhe diskutimin tim në procesverbal.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Konstatoj Kuorumin prej 19 anëtarëve të Kuvendit, prezentë.

* **Kuvendi i Komunës së Shtimes, me 17 vota “Për” me 0 vota “Kundër” dhe me 2 vota “Abstenim” miratoi Ekstrakt-Procesverbalin e Kuvendit nga mbledhja e mbajtur më 29.11.2024, me vërejtjen e Gëzim Haxhiut.**

Pika 2

Propozim-Vendim për anulimin e Vendimit Npi-01-156 dhe Planin për Integritet Npi-01-157 të datës 27.04.2023

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Për prezantimin e kësaj pike fjalën ia jap Valon Januzi.

z.Valon Januzi, drejtor i Administratës: Përshëndetje. Duke u bazuar në Ligjin e ri, Nr.08/L-017, për Agjensinë për Parandalimin e Korrupsionit, si dhe Vendimin e drejtorit të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit Nr.01-1476/23 të datës 26.07.2023, për miratimin e metodologjisë për Planet e Integritetit, në Komunitet e Kosovës, i propozojmë Kuvendit të Komunës miratimin e vendimit për anulimin e Vendimit Npi-01-156 dhe Planin për Integritet Npi-01-157 të datës 27.04.2023. Plani i ri për Integritet do të harmonizohet me obligimet strategjike të përcaktuara me Ligjin e ri Nr.08/L-017, dhe si rrjedhojë Planin e ri për Integritet do ta hartojë grupi punues sipas metodologjisë së këtij vendimi dhe do të miratohet nga Kryetari i Komunës.

z.Përparim Ramusa: Meqenëse ligji e thot për me anulë ne jemi “Pro”.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Konstatoj Kuorumin prej 19 anëtarëve të Kuvendit, prezentë.

* **Kuvendi i Komunës, unanimisht miratoi Vendim për ANULIMIN si vijon:**

1. **Vendimit për miratimin e Planit Komunal për Integritet 2023-2027, me numër Npi-01/156 të datës 27.04.2023,**
2. **PLANIN KOMUNAL PËR INTEGRITET Npi-01/157 TË DATËS 27.04.2023.**

Pika 3

Propozi-Vendim për plotësim-ndryshimin e vendimit Npi- 01-291 dt. 27.09.2022 për KKSB

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Në vazhdim lexoi emrat që duhet të ndryshohen në vendimin Npi-01-291 dt. 27.09.2022 për KKSB.

z.Përparim Ramusa: Ne në KPF kemi kërkuar që në Kuvend të ipen arsyetime. Ndryshimet që janë bërë në pozicione të ndryshme të anëtarëve të KKSB-së, kështu që ne nuk kemi arsye me e kundërshtuar.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Konstatoj Kuorumin prej 19 anëtarëve të Kuvendit, prezentë.

***Kuvendi i Komunës, unanimitisht miratoi Vendimin për ndryshim-plotësimin e vendimit të Kuvendit Npi-01/291 të datës 27.09.2022 për zgjedhjen e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, në përbërje si vijon:**

1. Qemajl AliuKryetar i Komunës së Shtimes,
2. Haxhi BehluliKomandant i Policisë – Shtime,
3. Gzim Morina.....Përfaqësues nga Forca e Sigurisë të Kosovës,
4. Skender BaftiuKryetar i KBI, dhe Imam i Xhamisë – Shtime,
5. Skender Dauti.....Përgjegjës i Zyrës për Mbrojtje dhe Shpëtim,
6. Bajram Gashi.....Komandant i njësisë profesionale për zjarrfikje dhe shpëtim,
7. Yllka Fejzullahu.....Drtejtorese e Drejtorisë për Arsim,
8. Reshat Gashi.....Kordinator për të Drejtave të Njeriut dhe Barazi Gjinore,
9. Muhamet Mehmeti.....Zyrtar për të drejta dhe integrim të komuniteteve në (ZKKK),
10. Arton DemiriPërfaqësues i Komunitetit Rom,
11. Xhavit Bungu.....Përfaqësues i Prindërve të shkollave në Komunën e Shtimes,
12. Shpresim Mahmuti.....Përfaqësues nga OJQ “ Rinova” Shtime,
13. Albert Ramadani.....Përfaqësues i Këshillit Lokal për Siguri Publike,
14. Muhadin Halili.....Përfaqësues i Këshillit Lokal për Siguri Publike,

Pika 4

Raporti i përgjithshëm i 6-mujorit të II të i Punës së ekzekutivit në Komunën e Shtimes

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Për prezantimin e kësaj pike, fjalën ja dha Kryetarit.

Kryetari, z.Qemajl Aliu: Përshëndetje. Ne e kemi obligim ligjor që të raportojmë së paku dy herë brenda vitit. Sot pra po e bëjmë prezantimin e raportit te punës së ekzekutivit. Sot buxheti i Komunës është 11 milion euro, ndërkaq që e kemi marrë me 7 milion ku ka rritje rreth 40%. Në vazhdim Kryetari prezantoi raportin me video-projektor, për projektet e planifikuara dhe të realizuara, gjatë vitit 2024.

znj.Adelina Beqaj: Një raport i vonuar. Ky raport i bukur por vetem ne foto. 58 projekte i ki që nuk ja ke filluar fare, e ti po hamendëson. Sa i përket druve dekorativ ti veq je tu i krastit sepse ato janë aty. Sa i përket rritjes së buxhetit, tregoju qytetarëve se sa ka rritje të tatimit. 76% e ke pas në vitin 2020 e tash sa e ki. Kontratat një burimore sa i ki nuk mundet me qenë kështu. Tregona cila është pamja e lumit Shtimjanja në krahasim me premtimet qe i ke dhënë, e ti i prezanton si të arritura tua. Në hotel emerald i ke harxhuar 1000 euro na tregon me kend dhe për çka i ke harxhuar. Diçka inovative në këtë raport nuk pashë. Më shumë mu duk si raport i fushatës.

z.Përparim Ramusa: 90% e raportit në fjalën tënde ishin rrena. E 10% ishin të vërteta. Qe tri vjet po e përmend QKMF-në e ende nuk ka asgjë. Po ashtu edhe objektin e Komunës. E përmende Parkun Industrial, ne e kemi bërë Parkun Industrial e ti po imagjinon për pronat e ardhëshme. 7 muaj nuk ke mujt me lidhë një kontratë. Nuk ke mujt me ble një Autoambulancë. Orarin e barnatoreve e ke mshel, e nuk kanë qytetarët ku me i ble barnat në mbramje. Te arsimi kalueshmëria është 42% në Shtime e 52 në Kosovë. Ke bërë kontratë një burimore për lëndët djegëse në shkolla. Këto që i prezantove nuk janë të arritura por dështime. Te projektet 10.000 euro i kemi dhënë dhe asnjë pllakë nuk është vendosë. 38.304 euro i ke shpenzuar për ndriçim në Shtime e që nuk kishin shku as 5.000 euro. Në vazhdim lexoi një listë të projekteve.

z.Reshat Mujota: E dëgjuam elaborimin e Kryetarit, unë i kam disa pyetje. Kemi një projekt për Kolektorin dhe Impijantin e trajtimit të ujrave të zeza në vlerë prej 5 milion eurove, dhe ende edhe sot nuk e kemi as Impiantin e as Kolektorin. Te stadioni vlera e projektit 200.000 euro, fusha e ghjelbërt kam kushtuar rreth 100.000 euro. Në raport ne kemi pritur edhe pjesën e

të hyrave, sepse qytetarët duan të dinë për tatimin e tyre. U fol për festivalin “Folk-Fest” kjo ka qenë komplet donacion nga Ministria e Kulturës dhe merita u takon atyre, e projektin e ka fitu shoqëria “Ilirida” në vlerë prej 7000 euro, ndërkaq që ju vetem e keni marrë nën patronat. U fol për mirëmbajtje të parqeve, e në disa parqe e unë nuk e di që në disa parqe i ka prek dikush, ndërsa për vitin 2025 ne po presim se çka do të bëhet. Pastaj edhe kishim dashur që të na raportoni për bashkëpunimin me OJQ “Jetimat e Ballkanit” dhe me na treguar për secilën shtëpi që është ndërtuar.

z.Muhamet Ademaj: Faleminderit për raportin. Ju përgëzoj për punën e mirë të ekzekutivit që e keni bërë. Koalicioni LDK-AKR-LVV ka bërë punë të mira, dhe duhet ti gëzohemi të gjithë. Ne e përkrahim këtë raport.

z.Asllan Beqaj: Përshëndetje. Unë po i kuptoj opozitën, sepse ky është një raport i madh, dhe këta nuk janë mësuar me pas një këso raporti. Sa i përket lumit, kush shkon rreth lumit në Petrovë e sheh që Lumi ka filluar me u pastruar dhe do të vazhdojë. Është thënë se nuk bëhet Çerdhja në Godanc ajo u bë. Është thënë nuk bëhet Obseravori, u bë. Edhe Çerdhen në Petrovë sot e kishim po mos të kishe votuar ti Adelina “Kundër”. Po thuani se nuk ka barna e qytetarët po thonë se ka barna dhe po u demantojnë. Folni me fakte sepse qytetarët po u shohin.

znj.Zejnije Veliu: Përshëndetje. Faleminderit për raportin. E lexuam dhe e pamë në tansi raportin e Kryetarit për punën e ekzekutivit. Investimet kanë filluar me Observatoriumin, ka vazhduar me investimet në fshatra si në Rancë, pastaj investime në arsim, në shëndetësi, pastaj donacionet në bujqësi. Projektet për dislokimin e Entit Special, si dhe ndërtimin e objektit të Komunës si objekte shumë të rëndësishme. Unë mendoj se raportin e kanë lexuar vetëm ata që kanë dashur ta lexojnë. Raporti tregon të arritura, tregon meritokraci dhe llogaridhënje.

z.Besnik Seferi: Nuk po i kuptoj opozitën, sepse nëse e shohim opozitën në nivelin qendror ku ata po thojnë se Shtimja ka një buxhet marramendës. Unë të përgëzoj Kryetar për punën e bërë, kështu që unë gjatë gjith mandateve të mija nuk kamë pa një raport të tillë. Nuk qëndrojnë kritikën e opozitës që nuk është bërë kurrfar pune. Është mirë që edhe ju opozita me thënë se edhe ne jemi pjesë e realizimit të këtyre projekteve, dhe është mirë që edhe ju me ardhur në promovimin e projekteve. Unë po dal ballhapur para qytetarëve sepse projektet janë bërë gjithëpërfshirëse. U përmendën investimet, QKMF-ja ka qenë në gjendje katastrofale, tani ajo është renovuar, si dhe është investuar shumë në furnizimin me barna, e në paisje sikurse është Mamografi i perhershëm etj.

z.Rexhep Gashi: Faleminderit për prezantimin e raportit. Raporti ishte një vjeqar e jo gjashtëmuor. Populizmi ka të bëjë me nivelin qendror. Në raport përveç të tjerave ka edhe gabime teknike, ka edhe gjëra të keqplanifikuara. Nëse e shohim projektin e rregullimit të stazave të biciklistave aty vlera është zero. Për asgjësimin e barnave të skaduara keni planifikuar 16 mijë euro e i keni kontraktuar me 5 mijë euro. Në vazhdim lexoi pjesë nga raporti dhe i komentoi ato.

znj.Adelina Beqaj: Deshta me repliku me Asllanin. Si kushteri po të tregoj se drejtoresha e partisë tënde e ka bërë kërkesën me emrin e fshatit Petroviç. Unë do ta arsyetoj votimin tim për QMF në Petrovë, dhe nuk do të thot që secili fjalim i joti me qenë kundër meje. E mua mos mu gjuj se nuk është e vertetë ajo që po e thua ti për mua.

z.Asllan Beqaj: Është e pa mundur për mos me marrë fjalën për këto shpifje, sepse kjo thot për diskutimet me qytetarë për QMF-në në Petrovë, kur dihet se vetëm një herë ka ardhur në diskutim publik dhe e ka ba bërlllog, ndërkaq që ne i kemi mbajtur disa takime me banorët. Mos shpif se kompania transportuese “Goni” nuk ka konkuruar asnjëher dhe nuk ka marrë asnjë projekt. Unë nuk mund ta kuptoj një njeri që nuk e voton çerdhen, e vjen këtu e thot pse nuk e keni bërë çerdhen. Nuk mundesh me ardhur këtu me shpif.

z.Rrahman Jakupi: Përshëndetje. Sa i përket raportit ky është vetëm një përshkrim i detyrave të punës të drejtorive se sa një raport pune. Sipas Instituti “GAP” i cili e ka publikuar një raport ka rezultuar se vetëm 45% ka realizim të projekteve. Është fakt se ka hetime penale në këtë qeverisje, sikurse është rasti i atijë drejtorit të mëparshëm të DSHMS-së. Tani në shëndetësi të gjithë janë Ushtrues Detyre. Çfar qeverisje është kjo me Ushtrues Detyre. Është fakt se këtu

kemi parë vendime të kundërligjshme. Far fakte po doni kur i kemi 5 vendime të kundërligjshme. Duhet me qenë modest edhe me i pranuar edhe dështimet e jo veq të arriturat. (Në vazhdim lexoi listën e projekteve dhe i komentoj ato, duke filluar me projektin e “Observatoriumit” në fshatin Rashincë). Shikoni rrugën “Mehdi Korrani” se far cilësie të dobët të punimeve është bërë. Adelina te lutem tregoj se farë cilësie është bërë kjo rrugë.

z.Lumni Amrushi: Përshëndetje. Po të drejtohem Kryesues sepse nuk mundesh me ja ndalë fjalën Adelina, sepse je tu e shkelë rregulloren e punës së Kuvendit.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Shkojmë në pauzë të drekës në ora 11:47h dhe kthehemi në mbledhje në ora 13:00h.

(Pauza)

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Vazhdojmë me mbledhjen në ora 13:13h. Kemi ngelur te pika e 4 e rendit të ditës Raporti i punës së Ekzekutivit. Besoj që pauza ka ndikuar për me u qetësuar në diskutime sepse vërtetë po dalim keq. Replikë për znj.Beqaj, dhe vazhdojmë tutje.

znj.Adelina Beqaj: Nuk pat arsye me ndodhë një situatë e tillë. Unë e kam një raport në dorë, ndërkaq që një anëtarë i Kuvendit nga VV-ja thot se je tu shpifë. Ky raport thot se transportin e nxënësve në Petrovë në vitin 2024 e ka bërë firma “Goni” në vlerën prej 5 mijë euro.

z.Asllan Beqaj: Prej fillimit vazhdimisht po shpifë për raportin. Kur nuk ka argumente kjo i kapet asambleistave. Firma transportuese “Goni Com” operon që nga paslufta, kjo e paguan tatimin rregullisht dhe gjithmonë rregullisht operon në mënyrë ligjore. Dhe duke i pas këto parasysh nuk është korrekte që në fshatin Petrovë me ardhur dikush nga jashtë me i transportuar nxënësit kur të gjitha kushtet ligjore i plotëson dhe firma është nga ky fshat. Unë jap dorheqje nëse e gjeni vetëm një parregullsi, nuk ka as edhe një pike më të voglën parregullsi me këtë operator. Jam i pastër deri tash dhe do të jem edhe në të ardhmen. Gjithmon kemi jetuar me djersën tone, prandaj edhe jemi kaq gjatë. Raportin e kamë përkrahur sepse është real dhe po kryhen punë të mira.

Kryetari, z.Qemajl Aliu: Më në fund pas dy orëve polemika, ku opozita po e përjeton rendë këtë raport, i cili ka shifra dhe ka dëshmi reale se projektet janë implementuar në tokën e komunës së Shtimes. Këto projekte janë për të gjithë banorët pra këto projekte po i prekin dhe po i shfrytëzojnë edhe këta opozitarë. Projektet normalisht që po vlerësohen lartë nga banorët e komunës tone por edhe nga jashtë. Pra 11 milion nga buxheti i Komunës edhe nja 15 milion të tjera nga donacionet nga Organizatat ndërkombëtare dhe vendore janë implementuar në komunën e Shtimes. Ne i kemi premtuar realizimin e 100 projekteve gjatë mandatit tone, mund te them se deri në fund të mandatit do ti realizojmë jo 100 por 300 projekte. Jemi në prag të vitit të ri 2025 dhe unë desha që sot në këtë mbledhje të kemi një atmosferë festive sepse edhe projektet janë në frymën e tillë. Ndërsa fjalët fyese dhe shpifëse le të mbeten në nderin e juaj.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Konstatoj Kuorumin prej 19 anëtarëve të Kuvendit, prezentë.

***Kuvendi i Komunës, me 10 vota “Për”, me 9 vota “Kundër”, dhe me 0 vota “Abstenim”, miratoi Raportin e gjashtë mujorit të dytë të punës së Ekzekutivit të Komunës së Shtimes për vitin 2024.**

Pika 5

Shqyrtimi i Draft-Planit të Punës së Kuvendit dhe Orarit të mbledhjeve për vitin 2025

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Para se të hapi diskutimin për këtë pike, ju njoftoj se edhe KPF-ja e ka miratuar dhe i ka rekomanduar Kuvendit për miratim. Hapi diskutimin.

z.Reshat Mujota: Pajtoj me këtë orarë dhe plan të punës nga Komisioni. Unë edhe më heret kamë thënë që ditët e Premte mos të jenë në orarin e mbledhjeve por të zëvendësohen me një ditë tjetër, me ditën e enjte psh. Sepse po na bjen me i pas 4 të premte.

z.Asllan Beqaj: Edhe unë pajtohem që dita e Premte të zëvendësohet me ditën e Enjte.

z.Rexhep Gashi: Te pika e parë në muajin Maj, propozoj që të jetë Informatë nga Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, e jo e Zhvillimit Ekonomik, sektori i bujqësisë, sepse tani kjo është drejtori e veqantë e nuk është në kuadër të DZHE-së.

z.Përparim Ramusa: Pajtohem me parafolësin Asllanin që orari nga dita e premte të zëvendësohen me ditën e enjte.

z.Muhamet Ademaj: E kemi pas të formuar një Komision për ta hartuar një draft për planin dhe orarin e Kuvendit, dhe duhet ta respektojmë punën e tyre. Edhe unë pajtohem që dita e Premte të zëvendësohet me ditën e Enjte.

z.Gëzim Haxhiu: Përshëndetje. Edhe unë pajtohem që dita e Premte të zëvendësohet me një ditë tjetër ashtu ciç e ceku Reshati.

znj.Albana Podvorica: Përshëndetje. Propozoj që pika e parë të muaji Shkurt që është “Informatë nga DKA për përfundimin e gjysëm-vjetorit të parë shkollor 2024/25” me u zhvendosë në muajin Janar. Edhe në muajin Gusht “Informatë nga DKA për përfundimin e vitit shkollorë dhe përgatitjet e fillimit të vitit të ri shkollorë 2025/26” ndoshta kishte me qenë më mirë sikur të zhvendoset në muajin Shtator si “Raport nga DKA për përfundimin e vitit shkollorë dhe përgatitjet e fillimit të vitit të ri shkollorë 2025/26”, sepse është një drejtori që me të vërtetë na duhet me pas informacione pak më shumë.

znj.Adelina Beqaj: Pjesa kur është përmendë dita e Xhuma në Komision unë e kam kontestuar për shkak se unë e kamë ditë që ka këtu anëtarë të Kuvendit që shkojnë e falin Xumanë dhe nuk mundën me arritë për shkak të volumit të madh të punëve në Kuvend, mirëpo 3 anëtarë kanë thane se i kemi mbajtur edhe të premtën dhe mundemi me i majtë se nuk është problem. Po du mi tregu Sanije Sadikut se Komisioni e ka bërë një punë serioze e nuk ka kurgjë për me keshë.

z.Lumni Amrushi: Meqenëse edhe Gzimi u pajtua me Reshatin, tash edhe unë pajtohem.

z.Reshat Mujota: Unë nuk e pata për me nënçmuar punën e Komisionit, por vetëm po kërkoj që dita e Premte të zëvendësohet me ditën e Enjte, realisht mua nuk më pengon, por pse me marrë pauzë e me e stërgjatë shkak i Xhumasë.

z.Përparim Ramusa: Propozoj që në mundësisht kësaj here po e votojmë kështu si është, por me mundësinë që Kryesuesi të mos e thërret mbledhjen e Kuvendit në ditën e Premte, vetem nëse nuk ka mundësi tjetër.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Konstatoj Kuorumin prej 19 anëtarëve të Kuvendit, prezentë.

***Kuvendi i Komunës, unanimitisht miratoi, Planin e Punës dhe Orarin për mbajtjen e mbledhjeve të rregullta të Kuvendit të Komunës së Shtimes për vitin 2025.**

Pika 8

Pyetje - Përgjigje

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Reshat Mujota: Ne po bëjmë pyetje por përgjigjet nuk po i marrimmë e keqja është se pyetjet po janë të porositura nga qytetarët. Pyetje për DPUKGJ-në, në fshatin Carralevë të lagja Balaj, me rreth 30 shtëpi me një rrugë shumë të ngushtë është kërkuar që rruga e tyre të zgjerohet dhe të shtrohet me asfalt, kanë problem që nuk e kanë lidhur çështjen e kanalizimit në atë lagje si dhe me e funksionalizuar ndriçimin publik? Pyetje për DSHP-ë në fshatin Belinc të Segmenti “Skënderbeu” konkretisht rruga “Xhon Buzuku” është një problem, ata banorë kanë paraqitur një kërkesë dhe kërkojnë që të jetë ndriçimi? Po ashtu edhe një pyetje konkrete për Drejtorin që është prezent dua me pyet për fshatin Mollopolc pikërisht për trotuarin të cilin e keni votue, stërvotue e bartë nëpër buxhete të rruga “Zona e Nerodimes” ku lidhet me rrugën “Fadil Rashiti” deri te ura në Mollopolc aty asnjë veprim nuk është bërë e as nuk ka buxhet të ndarë as për vitin 2025, kështu që pyetja është a do të bëhet Trotuari në atë pjesë? Pyetje për DSHP-ë dritat në rrugën kryesore të fshatit Mollopolc deri te Çeshmja, dhe te rruga “Hanumshahe Mujota”, dritat nuk po funksionojnë ka më shumë se pesë muaj dhe nuk ka ardhur kush me i ndrruar?

z.Muhamet Ademaj: Pyetje për DZHE-ë Kur pritët përfundimi i punimeve në “Zonën Ekonomike” në fshatin Gllavicë?

z.Përparim Ramusa: Unë, pyetje direkte nuk kamë, por Kryetarit i uroj vitin e ri, po ashtu uroj që viti 2025 të jetë më i begatshëm. Kam edhe një urim më special, uroj që ky Kryeministër

z.Albin Kurti mos të na udhëheqë vendin në vitin 2025, por shpresoj që vendin do ta udhëheqë kandidati i PDK-së z.Bedri Hamza.

z.Besnik Seferi: Meqenëse Përparimi e nisi me humor edhe unë po i them me humor se ti mund të kesh dëshira, mirëpo dëshira është dëshirë dhe përfundon sikurse bora e cila po bjen por shpejt po shkrihet, kështu që është e pa realizueshme. Pyetje për DSHP-në, ku jemi me kontratën për mirëmbajtje? Pyetje për DSHP-në, lidhur me qenët endacak, e din drejtori i Zhvillimit Ekonomik ku jemi me këtë çështje sepse është bërë një brengë për qytetarin? Pyetja e tretë është për Kryetarin, lidhur me rrugën kryesore Carralevë-Belinc, e pamë se rruga ishte rregulluar dhe mirë kishe bërë, mirëpo një pyetje konkrete që është për ty është se a planifikohet diçka konkrete për rregullimin e asaj rruge?

z.Rexhep Gashi: Pyetje për Administratën, në Rregulloren për Taksa dhe Gjoha a po lirohen veteranët, te zyrtarët e sporteve kur e qojnë kartelen me afat të skaduar. Veterani nuk e dëshmon me kartelë por me çertifikatë. Ka nja 9 raste që nuk janë liruar nga taksa, kërkoj një përgjigje me shkrim? Pyetje për DPUKGJ-në, ju si drejtori i keni premtuar banorit Avdullah Shabani e kam një autorizim të tijë, se ai qysh heret e ka një problem me kanalizim. Atijë i keni premtuar se do të intervenojmë, e meqenëse ju i keni premtuar kur do ta bëni rregullimin e kanalizimit dhe asfaltimin e rrugës së tijë?

z.Gëzim Haxhiu: Pyetje për DPUKGJ-në, kur do të bëhet rregullimi i Trotuarit te rruga “Fejzullahu” në fshatin Muzeqinë.

znj.Adelina Beqaj: Sa i përket kësaj pike unë pyetje kam bërë në dy seancat e kaluara e kaluara e përgjigje nuk kam marrë. Nuk pash asnjë pyetje nga ana e Kuvendit për banorët e fshatit Rashinc, çka ka ndodhur me këta banorë, pse po dalin me kundër reagime Pse reagimi i juaj është ndryshe e i atyre ndryshe, kisha pas qef që këtë pyetje me e specifikuar më shumë për banorët e fshatit Rashinc?

z.Reshat Mujota: Pyetje për DPUKGJ-në, pasna harruar pyetjen pikërisht për Trotuarin prej Hallës Sportive deri te Çeshmja e Mujotëve. Ky ka qenë projekt i buxhetuar, pse nuk është realizuar, e nuk e kam pa as në vitin 2025?

z.Rrahman Jakupi: Deshta me ju bashkangjit pyetjes së Adelinës për një përgjigje me shkrim se farë është duke ndodh me projektin e ujit në fshatin Rashinc? Pyetja e dytë është nga një banorë tash më i njohur që e kemi diskutuar që ka të bëjë me ndërtimin e objektit te pensionistët, pyetja është pse sështë pranuar ndërtimi i objektit nga Halil Kastrati me 70% nga Komuna? Si dhe te rruga e “Ohrit” u është premtuar se do të shtrohet këto ditë mirëpo ende nuk është shtruar. Pyetja e tretë ka të bëjë me fshatin Mollopolc në lagjet tjera e kanë kërku kanalizimin, kisha pas dëshirë me marrë me shkrim se far është duke ndodhur me atë lagje? Pyetjet kisha pas qef me mi kthy me shkrim.

z.Lumni Amrushi: Ne po bëjmë pyetje por përgjigjet nuk po i marrim. Kurë do të përfundojnë punimet në palestrën e sportit në fshatin Pjetërshticë? Kur do të bëhet trotuari në lagjen “Dugolli”? Kur do te behet pastrimi i lumit qe e keni premtuar ne fushatë? Ndriçimin publik e kamë ngritur edhe më heret, kur do të bëhet intervenimi në ndriçimin publik?

z.Rrahman Jakupi: Kamë bërë një kërkesë për qasje në dokumente publike, kërkoj me ma kthy përgjigjen me shkrim.

z.Besnik Seferi: Nevoitet mirëmbajtja te busti i “Komandant Tamulit” te shkolla fillore në Lagjen e Pajtimimit.

Kryetari, z.Qemajl Aliu: Lidhur me pyetjen e zotri Seferit për rrëshqitjen e dheut në Rrugën kryesore në Carralevës, ajo është sanuar përkohësisht. Ndërsa rruga prej rrethrotullimit të Pishave te Belincit e deri faktikisht në Prizren kjo rrugë është e buxhetuar në Ministrinë e Infrastrukturës dmth. do ti nënshtrohet një rikonstruktimi total. Lidhur me problemin e mungesës së energjisë elektrike me KEDS-in, me ket rast po e bëj një sçarim për gjithë qytetarët e komunës së Shtimes se, këto ditë unë kam pas 3 takime me radhë me udhëheqësit e KEDS-it dhe KOST-it edhe me ZRRE-në dmth. janë tri institucione qe kemi diskutuar lidhur me mungesën e energjisë këto ditë. KEDS-i si kompani private është e obliguar edhe për shpërndarjen e energjisë por edhe për faturimin e saj. Reduktime nuk ka vetem në komunën e

Shtimes por ka edhe në Lipjan, Ferizaj, Viti, Malishevë, Dragash e në gjithë Kosovën. Sipas asaj që më kan spjeguar, të tre këto Institucione, Komuna e Shtimes e ka një Linjë të përbashkët me komunën e Lipjanit prej 35KW, kështu që deri këtë vit ka mjaftuar por tash rritja e shpenzimeve, zhvillimi por sidomos rritja e shpenzimeve te ngrohjes me energji elektrike e kanë ngarku rrjetin energjetik dhe nuk po munden me e përballu këtë ngarkesë, ky problem nuk është vetëm në komunën e Shtimes por në gjithë Kosovën. Për me ulë këtë ngarkesë duhet që herëpashere me i nderpre disa fshatra për me mujt me pas në anën tjetër energji e mos me ra krejt sistemi i tensionit te lartë. Dhe tash për me furnizu mjaftueshëm komunën e Shtimes nevoiten diku rreth 25KW. Janë në dijeni të gjithë akterët edhe kompanitë por edhe ministritë. Siç e dini ne këtu në Kuvend ja kemi nda një parcelë KOST-it për ndërtimin e një Nënstacioni 110KW të energjis elektrike e cila pritet të ndërtohet së shpejti por që dinamika e zhvillimit nuk po pret, mirëpo ne do të kërkojmë që ta prioretizojmë që ky Nënstacion të bëhet para dimërit të vitit 2025. Ne po e kërkojmë mirëkuptimin e qytetarëve tanë për këtë çështje. E shfrytëzoj rastin të ju uroj vitin e ri 2025 një vit më të begatë. I kuptoj edhe shqetësimet e disa bashkëatdhetarëve këto ditë, që po na kontaktojnë. Po ashtu bashkëatdhetarëve tanë ju uroj mirëseardhje pushim dhe kthim sa më të mirë dhe të rehatshëm në vendlindjen e tyre.

z.Besnik Ahmeti, drejtor i DBF: Përshëndetje. Lidhur me pyetjen e Rexhep Gashit për Veteranët, që ka të bëj me rregulloren për Taksa, nëse ka ndonjë rast që ka ndodhur e që nuk është liruar, lirisht le të vijë te zyra ime dhe do ti rregullojmë të gjitha parregullsitë.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Para se ta mbylli mbledhjen, kërkoj nga drejtorat që përgjigjet ti kthejnë me shkrim. Pasi që diskutime të tjera nuk kishte, Kryesuesi mbledhjen e Kuvendit e përfundoj në ora: 14:12h.

Procesmbajtësi
Idajet Rexhepi



Kryesuesi i Kuvendit
Adnan Ademi

